



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235898
Datë: 11.12.2023
Numri i dokumentit: 05043160

C-IV.-14-6623

Ankuesi :

S K nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson **D B av**, nga Ferizaj.

Kundër

E paditura :

N.SH “Eurometal” -Ferizaj, e përfaqësuar nga
Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me dt. 11 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa e ankuesit si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI057-0267 i dt.11 korrik 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **S K** në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën Maj- Tetor 1990, t’i paguaj **shumën prej 1,241.00 €** dhe në emër të interesit ligjor prej 10 % të shumës themelore, t’i paguaj **shumën prej 124.10 €**, në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.
- 3. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej **125.00 €**.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Përfaqësuesi i ankuesit ka theksuar se ankuesi me shumë punëtor tjerë të N.SH-së në gusht të vitit 2013 kanë paraqitur padi ndaj vendimi të Autoritetit të Likuidimit të N.SH-së, por me urdhër

të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Suprem të Kosovës (DHPGJS) C-IV-13-1564 të dt. 11 shtator 2014, ishin urdhëruar që të paraqesin ankesa të veçanta.

Me 15 tetor 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. GJI057-0267 dt.11 korrik 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara në shumë prej 1,241.00 €, nga N.SH “Eurometal” Ferizaj (në likuidim). Ankuesi pohoi se e kundërshton vendimin e AL për shkak se ka qenë në marrëdhënie të punës tek NSH dhe se pa bazë ligjore nuk i janë paguar të ardhurat personale prej majit deri në muajin tetor të vitit 1990, ndërsa në muajin nëntor ankuesit me punëtorët e tjerë janë larguar në mënyrë arbitrare e të kundërligjshme. Ka shtuar se pas largimit nga puna ka ushtruar padi në Gjykatën kompetente kundër vendimit mbi largimin nga puna dhe për pagesën e pagave, duke kërkuara edhe pagesën e pagave të pa paguara. Ka kërkuar që ankesa e tij të aprovohet lidhur me shumën e kërkuar si dhe ka kërkuar kamatën dhe shpenzimet e procedurës.

Të njëjtës i ka bashkangjitur këto prova: njoftimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 të dt.10.05.2013, një listë të paguarave dhe të papaguarve për punëtorët për vitin 1990, nr.114. propozimin drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar Prishtinë për pagimin e të ardhurave personale 04 shkurt 1991, Regjistri i punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pran NSH Faknit- Eurometal- Ferizaj, për muajt Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, të vitit 1990 nr.08 dt.27 mars 2006.

Me 18 janar 2022, ankuesi e ka parashtruar në gjykatë një parashtrësë, me të cilën e ka njoftuar gjykatën se tani e tutje e përfaqëson av. D B, nga Ferizaj dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së Odes së avokateve.

Me 22 qershor 2023, e paditura parashtrroi mbrojtje në ankesë në të cilën pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se vendimi i AL nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se nuk ka asnjë bazë për ta shfuqizuar. E ka theksuar rregullin se ankuesi e ka barrën e provës në kuptim të nenit 7 të LPK-së dhe nenit 31 të ligjit të DHPGJS. Ka theksuar se sipas pohimit të ankuesit kërkesa për paga është refuzuara nga Gjykata, andaj AL nuk kishte kompetenca që ti vlerësonte ligjshmërinë e vendimeve të Gjykatave prandaj edhe është refuzuar. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Me 16 mars 2023, përfaqësuesi i ankuesit ka parashtruar përgjigje në ankesë dhe ka bashkangjitur përsëri provat të cilat i ka dorëzuar me herët. I ka propozuara gjykatës aprovimin e ankesës si të bazuar.

Me parashtrësën e dt. 03 gusht 2023, përfaqësuesi i ankuesit përsëri ka kërkuar që ti paguhen shpenzimet e gjyqësore dhe atë: për ankesën e parashtruar në Gjykatë shumën 104 € dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21 €.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i Autoritetit të Likuidimit nr. GJI057-0267 dt.11 korrik 2013.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Është rregull ligjor dhe procedural që: *“Pagat - rrogat paguhen: të paktën çdo muaj punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe të shoqëruara me dëftesën e pagesës.*

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i N.SH “Faknit” tani “Eurometal”, në Ferizaj. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e të provuarit se a i ka mbetur N.SH borxh paga të pa paguara ankuesit. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se i njëjti nuk ka dëshmuar me prova, me arsyetim se ankuesi nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat e dorëzuara me ankesë.

Nga njoftimi Ref.nr.Gj.A.nr.414/2019 dt.10.05.2013 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, (shih tek lënda kolektive C-IV-13-1564) vërtetohet se lëndët me të cilat punëtorët kanë kërkuar aktgjykim nga Gjykata Themelore në Ferizaj, ishin të regjistruara dhe të pa kryera. Po ashtu me kopjen e propozimit për pagimin e të ardhurave personale drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar vërtetohet se në mesin e propozuesve gjendet edhe emri i ankuesit.

Me regjistrin e punëtorëve për realizimin e borxhit të mbetur pranë N.SH “Faknit” për muajt maj – tetor 1990, e cila përmban vulën e N.SH “Eurometal” me nr.08 dhe dt.27.03.2006 vërtetohet se në mesin e punëtorëve gjendet emri i ankuesit S K, ku specifikohet shuma e cila i takon prej 1,241.00 €. Ky regjistër është i nënshkruar nga Kryetari i punëtorëve - S.V, Drejtori K- Q.Q dhe Financat - H.A.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e shtjelluara më lart, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime punë për N.SH-në, për periudhën maj – tetor 1900 dhe se për këtë periudhë i takon kompensimi për paga të papaguara në shumë prej 1,241.00 €. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për N.SH- në periudhën e lartcekur, apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Edhe nga dëshmitë tjera shtesë të cilat i ka prezantuar ankuesi para gjykatës siç janë: Informata nr.3142 dt.02.10.1990, parashtresa nr.1128, Propozim drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar Prishtinë për pagimin e të ardhurave personale dt. 04 shkurt 1991, konstohet se ankuesi në vijimësi që nga viti 1991 e deri para AL, ka kërkuar pagesën e të ardhurave personale të cilat N.SH-ja i ka mbetur borxh.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vjen në përfundim se ankuesi S K, kishte ofruar shërbime punë për N.SH dhe se N.SH-ja i kishte mbetur borxh pagat për periudhën e lartcekur dhe kësisoj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e aprovuar.

Gjykata e aprovon shumën në lartësi prej 124.10 €, në emër të interesit ligjor bazuar në nenin 37.3 të shtojcës së Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Sipas nenit të lartcekur të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e paditura AKP si palë e pasuksesshme, obligohet ti paguaj shpenzimet e procedurës.

E paditura është obliguar ti paguaj ankuesit shpenzimet e procedurës dhe atë në bazë të rregullores së tarifës së Odës së Avokatëve, për ankesë shumen prej 104.00 €, ndërsa 21 € për taksën gjyqësore, pra gjithsejtë shumen prej 125.00 € .

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Shkelzen Sylaj